

Të mbrojmë mjedisin për të ardhmen tonë dhe vendin ku jetojmë!

Rrethanat dhe mjedisi ndikojnë mbi ne, por ne jemi përgjegjës për vetveten.

Paulo Coelho

Në këtë buletin do të gjeni:

Fushata ndërgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit

Shqipëria si pjesëtare e Byrosë të Protokollit për PRTR

Faqe 1

Inspektimet e operatorëve për mjedisin dhe përdorimin e burimeve ujore

Përmirësimi i regjistrave të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve

Faqe 3

Përmirësimi i menaxhimit të kimikateve në Shqipëri

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pjesë e Rrjetit European të Vëzhgimit dhe Informacionit Mjedisor të Agjencisë Europiane të Mjedisit

Faqe 2

Pjesëmarrja e AKM-së në Këshillin Kombëtar për Faunën e Egër

Faqe 4

Rubrika

“Mesazhe Ndërgjegjëse”

Faqe 4

Fushata ndërgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit

Misioni i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është mbrojtja e mjedisit për të ardhmen tonë dhe vendin ku jetojmë!

Në përmbushje të misionit tonë gjatë periudhës Tetor-Dhjetor janë organizuar takime ndërgjegjëse me përfaqësues të 38 bashkive dhe 19 bizneseve të ndryshme të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në këto zona.

Synimi i takimeve ishte njohja me gjendjen në mjedis, problematikat e hasura dhe rekomandimet e Raportit të Gjendjes në Mjedis 2020.



Rekomandimet e Raportit të Gjendjes në Mjedis 2020, shërbejnë si një bazë e mirë për ndërgjegjësimin e bashkive dhe bizneseve në mbrojtje të mjedisit. Gjithashtu ndihmojnë në hartimin e politikave më efikase jo vetëm në përmirësimin e gjendjes së mjedisit, por edhe në parandalimin e ndikimeve në mjedis.

Për këtë arsye gjatë takimeve me bashkitë dhe bizneset u theksua rëndësia e përfshirjes së rekomandimeve në planet e tyre për mjedisin si dhe ndërmarrjen e veprimeve për treguesit kryesor të mjedisit të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e gjendjes mjedisore në vendin tonë. Nxitja e bizneseve për ushtrimin e aktiviteteve duke përdorur teknologjinë e duhur si dhe marrjen e masave për trajtimin e shkarkimeve në ajër, ujë dhe tokë për të minimizuar ndotjen e mjedisit.

Ndërgjegjësimi për ndërmarrjen e veprimeve që këto rekomandime të mos mbeten thjesht në letër por të përfshihen në planet për mjedisin dhe të kthehen në veprime konkrete për mbrojtjen e mjedisit.

Shqipëria si pjesëtare e Byrosë të Protokollit për PRTR

Gjatë periudhës 18-22 Tetor 2021, në Gjenevë u mbajt sesi i shtatë i Takimit të Palëve në Konventën e Aarhus-it si dhe sesi i katërt i Takimit të Palëve në Protokollin mbi Regjistrat e Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve (PRTR), dhe takimet e tyre të përbashkëta të Segmentit të Nivelit të Lartë dhe të lidhura me to. Në këtë takim Agjencia Kombëtare e Mjedisit u përfaqësua nga pika fokale e protokollit të PRTR-it, Zj. Enkeleda Shkurta.

Sesionet gjatë kësaj jave treguan edhe një herë rëndësinë e bashkëpunimit shumëpalësh për demokracinë mjedisore duke përmendur:

Guinea-Bissau u mirëprit si vendi i parë jashtë rajonit të ECE që aderoi në Konventën e Aarhusit.

Mekanizmi i reagimit të shpejtë të Konventës së Aarhusit për ruajtjen e mbrojtësve të mjedisit është krijuar nën udhëheqjen e Austrisë dhe Irlandës.

Janë miratuar 20 vendime për pajtueshmërinë me Konventën e Aarhusit për të ndihmuar palët individuale për të përmirësuar legjislacionin dhe praktikën e tyre në fusha të tilla si nxjerrja e naftës dhe gazit, miniera e arit, termocentralet bërthamore, energjia e rinovueshme, linjat e energjisë, planifikimi urban dhe hapësinor, aksesit, drejtësisë, mbeturinave, pylltarisë dhe sigurisë së mbrojtësve të mjedisit.

U miratuan rekomandime për të promovuar përdorimin e mjeteve elektronike të informacionit për të mbështetur zbatimin e Konventës në dritën e tranzicionit të vendeve drejt dixhitalizimit.

Disa Palë të ofruara për të udhëhequr fushat kyçe të punës sipas Konventës dhe vendimeve përkatëse u miratuan si më poshtë:

- ✚ Republika e Moldavisë – për akses në informacion;
- ✚ Italia – për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje;
- ✚ Belgjika – për akses në drejtësi;
- ✚ Austria – për organizmat e modifikuar gjenetikisht;
- ✚ Franca – për promovimin e parimeve të Konventës në forumet ndërkombëtare.

Një vendim për rrugën përpara për zhvillimin e Protokollit u miratua nga Takimi i traktatit të Palëve për t'i bërë PRTR-të një mjet të dobishëm për vendimmarrje në fusha të ndryshme, si shëndeti publik, konsumi i burimeve, planifikimi urban, reduktimi i emetimeve dhe më shumë.

Takimet e palëve në të dy traktatet miratuan Deklaratën e Gjenevës për Demokracinë Mjedisore për Zhvillim të Qëndrueshëm, Gjithëpërfshirës dhe Elastik, duke përforcuar kështu angazhimin e tyre për promovimin e vendimmarrjes transparente dhe pjesëmarrëse për infrastrukturën dhe planifikimin hapësinor. Folës të shquar nga palët dhe shoqëria civile ndanë përvojat e tyre se si Konventa e Aarhusit dhe Protokollit mbi PRTR-të po përdoren për të mbështetur infrastrukturën e qëndrueshme dhe planifikimin hapësinor në Segmentin e Përbashkët të Nivelit të Lartë.

Takimet e Palëve ranë dakord gjithashtu për programet e punës dhe aranzhimet financiare për të udhëhequr aktivitetet e ardhshme deri në vitin 2025. Më tej, ata zgjodhën anëtarë të dy Komiteteve të Pajtueshmërisë (për Konventën dhe Protokollin) dhe të dy Byrovet (për Konventën dhe Protokollin).

Byroja e Mbledhjeve të Palëve u zgjodh në sesionin e katërt të Takimit të Palëve në Gjenevë, të mbajtur nga 21 - 22 tetor 2021. Anëtarësia e saj aktuale është e përbërë nga 1 Kryetar, 2 Nënkyetarë dhe 4 anëtarë. Vendi ynë përfaqësohet nga Pika Fokale e Protokollit të PRTR si një nga nënkryetarët.

The screenshot shows the UNECE website with the following information:

- Organization: UNECE SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS
- Language: English
- Search: Advanced Search
- Navigation: COVID-19 Response, About UNECE, Our work, Themes, SDGs, Open UNECE, Events, Publications, Media
- Current Page: ENVIRONMENT POLICY / PUBLIC PARTICIPATION / PROTOCOL ON PRTRs BUREAU
- Section: Protocol on PRTRs Bureau
- Text: The Bureau of the Meeting of the Parties was elected at the fourth session of the Meeting of the Parties in Geneva, held from 21 to 22 October 2021. Its current membership is as follows:
- Chairperson: Mr. Tone Kvasič (Slovenia)
- Vice-Chairpersons: Mr. Alex Radway (European Union), Ms. Enkeleda Shkurta (Albania)
- Members: Ms. Marie-Rose van den Herde (Belgium), Mr. Eduard Hlavaty (Czechia), Ms. Teresa Palomar (Spain), Mr. Bohdan Papusha (Ukraine)

Përmirësimi i menaxhimit të kimikateve në Shqipëri

Në kuadër të projektit i “Përmirësimi i menaxhimit të kimikateve në Shqipëri” specialistët e Sektorit të Kimikateve kanë qënë të pranishëm në takimin ndërinstitucional me temë “Trajnim mbi legjislacionin e kimikateve për inspektorët” në datat 1-3 Dhjetor 2021 me pjesëmarrjen e specialistëve të Agjencisë Suedeze të Kimikateve, KEMI, SIDA.

Në këto takime fokusi ishte dhënia e ekspertizës suedeze në plotësimin e kërkesave të zbatimit të ligjit Nr.27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, me objektiva:

- Pasqyrë e legjislacionit të kimikateve në Shqipëri dhe lidhjet me legjislacionin e BE-së
- Klasifikimi, fletët e etiketimit dhe të dhënat e sigurisë
- Aktet ligjore dhe rregulloret.
- Si të implementohen rregullat duke përfshirë shembuj praktik.
- Kufizimet dhe kërkesat për autorizim.



Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pjesë e Rrjetit Europian të Vëzhgimit dhe Informacionit Mjedisor (EIONET), të Agjencisë Europiane të Mjedisit (EEA)

Rrjeti Kombëtar EIONET, pjesë e Agjencisë Europiane të Mjedisit gjatë periudhës Shtator–Dhjetor 2021 ka vijuar normalisht punën në drejtim të përmbushjes së detyrimeve, që lidhen me kryerjen në kohë dhe cilësinë e duhur të raportimeve mjedisore të Shqipërisë, pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese dhe informuese, seminare, takime pune, evente online, pjesë e Planit të Punës së EEA me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Aktivitetet më të spikatura të zhvilluara gjatë kësaj periudhe:

Në kuadër të projektit të EEA “Forcimi i Pjesëmarrjes së Vendeve të Ballkanit Perëndimor në punën e EEA 2020-2021 me fokus ujërat dhe vlerësimin e pritshmërive mjedisore”, në bashkëpunim të ngushtë me European Topic Center për Ujërat Bregdetarë, Detarë dhe Larës të EEA, është zhvilluar një paketë e plotë trajnimesh, seminaresh, eventesh online nga ana e ekspertëve të EEA për ekspertët shqiptarë. Ky projekt financohet nga instrumenti IPA II, BE dhe në fokus të tij është ngritja dhe forcimi i kapaciteteve kombëtare në fushat e mëposhtme:

a- Përmirësimi i raportimeve mjedisore të Shqipërisë në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare.

b- Mbështetje në rritjen dhe forcimin e kapaciteteve teknike në linjë me Axhendën e Gjelbër të Bashkimit Europian për Qëndrueshmërinë me fokus menaxhimin e bazuar tek ekosistemet.

c- Mbështetje e aktiviteteve pilot për forcimin e raportimeve në kuadër të WISE (Water Information System for Europe-Sistemi Europian i Informacionit për Ujërat)

Një tjetër komponent i rëndësishëm i kësaj pakete, me rëndësi kombëtare, që do të finalizohet në muajt në vijim, është Studimi Kombëtar mbi Situatën e Menaxhimit të Ujërave në Shqipëri, shoqëruar me ngritjen e data bazës kombëtare të sasisë së ujërave të disponueshme në vend, e cila është detyrim raportimi në EEA.

Në muajin Shtator 2021, u zhvillua takimi i radhës së Bordit Menaxhues të Agjencisë Europiane të Mjedisit me pjesëmarrjen e gjithë vendeve të EIONET, anëtare dhe jo anëtare, përfshirë edhe Shqipërinë. Në këtë takim u miratua një paketë vendimarrjesh të rëndësishme strategjike për të ardhmen e punës së EEA dhe EIONET dhe implementimin e tyre, jo vetëm në nivel europian por edhe kombëtar, nga vendet raportuese në EEA. Kjo vendimarrje ka të bëjë me strukturën e re të EEA dhe EIONET, e cila tenton të ndërtojë një rrjet më gjithëpërfshirës e nivel ekspertize mjedisore me një qasje mjedisore më të integruar.

Në muajin Dhjetor 2021, Agjencia Europiane e Mjedisit në konsultim të ngushtë me vendet e Ballkanit Perëndimor, hartoi paketën e punës dhe aktiviteteve, që do të zhvillohen në vendet e Ballkanit Perëndimor për periudhën në vijim. Ky dokument do të paraqitet Komisionit Europian për miratim dhe financim i saj do të mbulohet nga instrumenti IPA III, BE. Fushat e punës së kësaj pakete janë në linjë me prioritetet e Axhendës së Gjelbër Europiane për Ballkanin Perëndimor dhe konsistojnë në fushat:

- biodiversiteti,
- ekonomia qarkulluese,
- ndryshimet klimatike,
- ndotja në ajër, ujë dhe toka.

Ekspertët e AKM me mbështetjen dhe asistencën teknike të institucioneve të tjera kombëtare, të përfshira në menaxhimin e mbetjeve dhe politikat e lidhura me to (GIZ dhe MTM) dhe nën udhëheqjen e ekspertëve të EEA për Ekonominë Qarkulluese dhe Mbetjet, hartuan dhe publikuan dokumentin teknik, “Profili Kombëtar mbi Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në Shqipëri”, i cili është lançuar nga EEA dhe është i aksesueshëm për gjithë publikun evropian.



Inspektimet e operatorëve për mjedisin dhe përdorimin e burimeve ujore

Drejtorja e Inspektimit- Kontrollit, Sektori i Burimeve Natyrore (ujërat) në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për periudhën Shtator-Dhjetor ka inspektuar operatorë që përfshihen në përdorimin e burimeve ujore si; “HEC, përpunimi i materialeve inerte lumore, veprimtaritë në brigje, veprimtaritë e prodhimit të ushqimeve e pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to, etj” Veprimtaritë dhe numri i inspektimeve për përdorimin e burimeve ujore paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Veprimtaria	Numri i inspektimeve të kryera
1	HEC, Përdorim i burimeve ujore për prodhim hidroenergjie	19
2	Fraksionim i materialeve inerte dhe veprimtari në brigje	4
3	Veprimtari në përpunimin e qumështit	2
4	Veprimtari e përpunimit të ullirit dhe nxjerrjes së vajit	8
5	Veprimtari në përpunimin e gurit të mermerit	2
6	Veprimtari në prodhimin e pijeve	2
7	Përpunim i peshkut dhe thertore	2
8	Veprimtari në shërbime Resorte	2

Synimi i inspektimeve ishte kontrolli i zbatimit të legjislacionit në bazë të lejes administrative të lëshuar nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore si dhe parimeve dhe kërkesave në Ligjin Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” i ndryshuar.



Gjithashtu nga Sektori i Mjedisit janë kryer inspektime të operatorëve të fushave të ndryshme të veprimtarisë si mëposhtë:

Nr	Veprimtaria	Numri i inspektimeve të kryera
1	Menaxhimi i mbetjeve	8
2	Industria Minerare	76
3	Veprimtaritë e katranit dhe të bitumit	7
4	Përpunimi i tekstileve ose fibrave	1
5	Trajtimet me regjie dhe prodhimi i lëkurës	1
6	Prodhimi dhe përpunimi i metaleve	1
7	Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to	16
8	Industritë energjetike	9
9	Industria kimike	2
10	Veprimtaritë e lëndës së drurit	2
11	Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve	4
12	Akuakulturë intensive	1

13	Industritë prodhuese të komponentëve	1
14	Prodhimi i mobilieve	1
15	Veprimtaritë e prodhimit të letrës, pulpës dhe dërrasës	1
16	Blegtoria	2
17	Veprimtaritë e gomës	1
18	Veprimtari të tjera	1


Për konstatimet e bëra nga ana e grupeve të punës, për gjetjet dhe shkeljet e kërkesave ligjore operatorët janë marrë masa administrative si dhe janë sensibilizuar në zbatimin e saktë të legjislacionit për përdorimin e burimeve ujore në fuqi, ligjit Nr. 10 448 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, VKM –ve respektive etj.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit do të vazhdojë të ushtrojë detyrat e saj funksionale për të garantuar, sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore si dhe mbrojtjen e mjedisit.

Përmirësimi i regjistrave të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve

Me rastin e 20 vjetorit të Konventës së Aarhus-it u mbajtën disa takime ku vendi ynë ishte pjesë e takimit mbi projektin e PRTR-it "Përmirësimi i regjistrave të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve (PRTR) në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Republikën e Moldavisë”.

Në këtë takim vendi ynë u prezantua me zhvillimet e arritura nga ky projekt.



Më shumë informacion mund të gjeni në linkun:

https://unece.org/environmental-policy/events/JHLS_Aarhus_MoP7_PRTRs_MoPP4

Pjesëmarrja e AKM në Këshillin Kombëtar për Faunën e Egër

Përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit morën pjesë në takimin e Këshillit Konsultativ të Faunës, drejtuar nga zëvendësministria e Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit Zj. Almira Xhembulla. Takimi kishte si qëllim ngritjen e Këshillit Kombëtar për Faunën e Egër si organi përgjegjës për këshillimin dhe kontribuimin në hartimin e programit të inventarizimit dhe zhvillimit të faunës së egër, planeve vjetore të mbarështimit dhe projekteve të faunës së egër, si dhe kalendarit të gjuetisë, listës së specieve, kuotave objekt gjuetie për çdo sezon gjuetie edhe kur gjuetia është e lejuar.

Në këtë takim u diskutua mbi Projektligjin e Moratoriumit të Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë. Qëllimi i këtij projektligji është ndalimi i ushtrimit të aktivitetit të gjuetisë, pezullimi i përdorimit të zonave të gjuetisë dhe pezullimi i gjuetisë në zonat e mbarështimit të faunës së egër.



Anëtarët e këshillit përfaqësues të federatës së gjuetarëve, përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë të fushës si dhe përfaqësues të MTM e pushtetit lokal dhanë rekomandimet e opinionet e tyre lidhur me projektligjin, por dhe problematikën e situatës së faunës në përgjithësi.

Ndërkohë të pranishmit u informuan për iniciativat që MTM po ndërmerr lidhur me edukimin mjedisor, ndëshkimet për krimet mjedisore si dhe rritjen e kërkesës ndaj njësive të qeverisjes vendore për të hartuar planet e tyre të mbarështimit dhe ngritjen e strukturave kompetente, të afta për të zbatuar detyrimet që vijnë nga kuadri ligjor në fuqi

“Mesazhe Ndërgjegjëse” Riciklimi i mbetjeve



Mbetjet e baterive dhe riciklimi i tyre

Riciklimi është një nga hallkat më të rëndësishme në hierarkinë e mbetjeve të përcaktuar në legjislacionin shqiptar për mbetjet. Në vendin tonë ka filluar grumbullimi dhe menaxhimi i mbetjeve të baterive dhe bazuar në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta 2020-2035, synohet që në vitin 2035 të kemi riciklim midis 50% dhe 75% për materiale të ndryshme të baterive.

Pse duhet të grumbullojmë dhe riciklojmë mbetjet e baterive?

Bateritë dhe pilat, të cilat na e bëjnë më të lehtë jetën, kur kthehen në mbetje ato bëhen të dëmshme për mjedisin. Përzierja me mjedisin e baterive të skaduara ose që kanë dalë jashtë përdorimit për arsye të dëmeve të ndryshme që kanë pësuar, shkaktojnë ndotjen e mjedisit në masë serioze. Mbetjet e baterive të cilat asgjësohen duke i djegur, përbëjnë një kërcënim për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Riciklimi minimizon gjenerimin e mbetjeve të baterive dhe hedhjen e pakontrolluar të tyre si dhe kontribuon ndjeshëm në ruajtjen e sipërfaqes së tokës, ujërave nëntokësore e sipërfaqësore dhe të bimësisë.

Efektet negative në shëndetin e njerëzve

Bateritë krahas përdorimit të tyre dhe anëve pozitive kanë edhe disa efekte negative, nëse hidhen si mbeturina për arsye se përmbajnë elemente toksik plumb dhe kadmium. Për njerëzit, plumbi dhe kadmiumi mund të merren nga gjëllitja apo frymëmarrja nëse këta elementë janë në ajër. Elementët toksik shkaktojnë, të përziera, dhimbje të barkut, mëlçisë, dëmtime në veshka, acarim të lëkurës, dhimbje koke, astma, nervozizëm, ul koeficientin e inteligjencës te fëmijët dhe nganjëherë madje shkakton kancer që mund të merret nga ekspozimi ndaj metaleve të tilla për një periudhë kohe të gjatë.

Çfarë duhet bërë për riciklimin e baterive.

Për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit, edhe bateritë, ashtu si çdo lloj produkti tjetër, duhet të grumbullohen veçmas dhe të dërgohen në destinacionet e duhura. Konsumatori është pika më e rëndësishme në grumbullimin e mbetjeve të baterive dhe dërgimin e tyre në pikat e grumbullimit të baterive. Për të ndihmuar riciklimin e tyre Pushteti Lokal, duhet të hartojë plane menaxhimi ku të përfshihet ndërgjegjësimi për riciklimin e tyre si ngritja e qendrave të grumbullimit, ku konsumatori të dërgojë mbetjet e baterive.



Mbetjet e plastikës

Pse duhet të riciklojmë mbetjet e plastikës?

Plastikat janë materiale të qëndrueshme, të lehta dhe të lira. Ato mund të formohen me lehtësi në produkte të ndryshme që gjejnë përdorime në një shumëllojshmëri aplikimesh. Si rezultat, prodhimi dhe përdorimi i plastikës janë rritur gjatë dekadave të fundit. Plastikët, nuk janë biodegradues, por me djegien e tyre ndotet ambienti jetësor edhe gjatë reaksionit të djegies lëshojnë masa kancerogjene në ajër. Plastika do më shumë se 100 vjet të shpërbëhet në tokë dhe shumë njerëz i hedhin qeset plastike kudo që mundin. Rrjedhimisht, ripërdorimi, rikuperimi dhe riciklimi i plastikës janë jashtëzakonisht të rëndësishme.

Efektet negative në mjedis dhe shëndet

Mbetjet nga plastika, paraqesin rrezik serioz mjedisor për shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe të gjitha gjallesave Ndikimi kryesor i hedhjes së plastikës në mjedis, është se duhen shumë vite që ato të shpërbëhen. Përveç kësaj, nëse mbeturinat plastike digjen, ato lëshojnë një substancë toksike në ajër, duke shkaktuar ndotjen e ajrit dhe si pasojë efekte negative në shëndetin e njerëzve. Njerëzit dhe gjallesat e tjera janë të ekspozuara ndaj kimikateve nga plastika shumë herë në ditë, përmes ajrit, pluhurit, ujit, ushqimit dhe përdorimit të produkteve të konsumit



Përfitimet nga riciklimi i plastikës

- 1-Ka të bëje me zvogëlimin e nevojave për land-filled;
- 2-Zvogëlimin e sasisë të mbetjeve;
- 3-Kursen energjinë;
- 4-Zvogëlon ndotjen;
- 5-Mbron burimet primare të cilat janë të pamjaftueshme;
- 6-Çon në uljen e gazeve me efekt serë

Çfarë duhet bërë për riciklimin e plastikës.

Materialet plastike të riciklueshme duhet të vendosen në koshin e përcaktuar për hedhjen e mbeturinave të plastikës për t'u tërhequr më pas. Është e rëndësishme që fillimisht të bëhet kategorizimi i plastikave sipas llojeve në mënyrë që të jetë më e lehtë për procesin e ndarjes dhe më pas riciklimin e tyre.

Bashkitë e vendit duhet të marrin masa për vendosjen e koshave për hedhjen e mbetjeve të plastikës. Ndëgjegjësimi i qytetarëve për ndarjen e plastikës duke filluar që nga shtëpitë e tyre, që konsiston në vendosjen e një koshi për hedhjen e materialeve të plastikës

Riciklimi i mbetjeve të letrës

Riciklimi i letrës është një praktikë që po përhapet gjithmonë e më shumë dhe që duhet bërë nga të gjithë, me qëllim reduktimin e sasisë së mbeturinave dhe ruajtjen e pemëve, pra krijimin e një eko-qëndrueshmërie të planetit. Grumbullimi i letrës së vjetër dhe ripunimi i saj do të ishte një ndihmë e rëndësishme për uljen e gjenerimit të mbeturinave të letrës dhe përmirësimin e mjedisit.

Përfitimet nga riciklimi i letrës

- ✚ Riciklimi ndihmon në reduktimin e çlirimit të gazit karbonik që nga aktiviteti industrial tek ai individual.
- ✚ Kontribuon ndjeshëm në ruajtjen e sipërfaqes së tokës, duke ulur sasinë e mbeturinave dhe minimizohet rreziku për shëndetin dhe mjedisin.
- ✚ Zvogëlohet shfrytëzimi i burimeve natyrore dhe ndihmon në ruajtjen e tyre duke ulur nevojën për lëndë të para.
- ✚ Kursehet kohë dhe energji.
- ✚ Përdorimi i materialeve të ricikluara mund të ulë dhe kostot e energjisë për prodhuesit, duke e krahasuar me koston e përpunimit të lëndëve të para.
- ✚ Ngritja e impianteve të riciklimin të letrës ndihmon në punësimin e njerëzve, ul ndotjen në mjedis
- ✚ Riciklimi i një toni letrë shpëton 17 pemë, duke kontribuar kështu në reduktimin e sasisë të dioksidit të karbonit në atmosferë
- ✚ Produktet e letrës së ricikluar kërkojnë vetëm 60% të energjisë dhe gjysmën e ujit të nevojitur gjatë procesit të prodhimit të letrës nga druri.

Pse duhet të kontribuojmë për riciklimin e letrës.

Çdo person ka të drejtë të jetojë në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij. Por gjithashtu ka dhe detyrën si individ dhe në shoqëri, që të mbrojë dhe të përmirësojë mjedisin për të mirën e brezave të sotëm dhe të ardhshëm.

Qytetarët duhet të ndërgjegjësohen për ndarjen e mbetjeve të letrës në shtëpitë e tyre, në institucionet ku punojnë apo në shkollat ku studiojnë. Bashkitë e vendit duhet të marrin masa për vendosjen e koshave për hedhjen e mbetjeve të letrës. Kontributi i gjithsecilit ndihmon në mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë të jetesës.



